384	20547	25.06.2009	Muhamet	Mushomataj	Zenjel	Doko	03.04.1891	Tepele	M	5 vjet 3 muaj 1 dite	3,838,000	0	330,000	0	0	3,508,000
385	20597	25.06.2009	Francesk	Coku	Gjin	Vitore	26.10.1919	Durres	M	1 vit 11 muaj 24 dite	1,460,000	70,000	237,555	0	0	1,152,445
386	20648	29.06.2009	Franco	Maka	Dode	Cole	20.03.1920	Shkoder	M	548 dite	1,096,000	60,000	188,007	0	0	847,993
387	20694	29.06.2009	Luk	Kacaj	Luk	Gjele	24.02.1924	Shkoder	M	4 vjet, 10 muaj, 8 dite	3,556,000	0	700,000	0	0	2,856,000
388	20715	29.06.2009	Visarion	Xhuvani	Jani	Efemi	01.05.1894	Elbasan	M	5667 dite	11,334,000	0	1,863,781	0	0	9,470,219
389	20758	29.06.2009	Gazi	Alicka	Hajdar	Fatime	22.01.1910	Erseke	M	11 vjet 4 muaj 21 dite	8,320,000	0	1,368,000	0	0	6,952,000
390	20760	29.06.2009	Aallan	Ypi	Xhaferr	Ismete	14.11.1911	Selanuk	M	13 vjet 5 muaj 22 dite	9,844,000	200,000	1,414,596	0	0	8,229,404
391	20800	29.06.2009	Leze	Rrathori	Pal	Pashkë	05.09.1913	Plan Shkoder	M	7 vjet 2 muaj 6 dite	5,246,000	0	860,631	0	0	4,385,369
392	20813	29.06.2009	Faik	Mugollari	Musa	Gjryze	22.03.1934	Kolonje Kamnik	M	5 vjet 2 muaj 5 dite	3,784,000	200,000	522,027	0	0	3,061,973
393	20829	29.06.2009	Neim	Conaj	Habip	Qomo	01.01.1913	Berat	M	D 1. 7 vjet 6 muaj 6 dite D 2. 5 vjet 1 muaj 2 dite	9,210,000	0	0	0	0	9,210,000
394	20848	30.06.2009	Aleksander	Curcia	Mikel	Roza	28.08.1927	Shkoder	M	2434 dite	4,868,000	100,000	699,233	0	0	4,068,767
395	20849	30.06.2009	Faik	Babani	Rushan	Ashire	07.08.1890	Baban, Korce	M	3916 dite	7,832,000	0	0	0	0	7,832,000
396	20955	30.06.2009	Xhevat	Sadikllari	Hvsmi	Rubije	13.06.1932	Sovjan	M	1469 dite	2,938,000	0	0	0	0	2,938,000
397	21008	01.07.2009	Adom	Tahiri	Tahir	Emine	1901	Shkoder	M	3 vjet 1 muaj 25 dite	2,302,000	0	0	0	0	2,302,000
398	21010	01.07.2009	Shuaip	Hasho	Feta	Zaho	08.08.1918	Manalat	M	7 vjet 9 muaj	5,668,000	100,000	829,000	0	0	4,739,000
399	21012	01.07.2009	Avdulla	Nure	Xhakoli	Ismete	02.09.1936	Bars, Korce	M	11 vjet, 4 muaj, 16 dite	8,110,000	0	1,366,685	0	0	6,943,315
400	21022	01.07.2009	Ali	Nezaj	Brah	Raze	11.06.1909	Tropoje	M	18 vjet 10 muaj	13,760,000	0	700,000	0	0	13,060,000
401	21066	01.07.2009	Tahir	Hoxha	Tahir	Kadife	27.09.1888	Librazhd	M	7 vjet	5,110,000	0	840,658	0	0	4,269,342
402	21068	01.07.2009	Sokrat	Dodhiba	Anastas	Polaksoni	08.08.1899	Elbasan	M	11 vjet 10 muaj 18 dite	8,686,000	0	1,423,010	0	0	7,262,990
403	21076	01.07.2009	Xhafer	Butika	Ibrahim	Jelidene	05.10.1918	Koroc	M	5209 dite	10,418,000	0	1,713,205	0	0	8,704,795
404	21077	01.07.2009	Agostin	Ashiku	Zef	Lucije	16.09.1905	Shkoder	M	1825 dite	3,650,000	0	600,000	0	0	3,050,000
405	21126	01.07.2009	Sali	Tarushi	Arif	Domke	03.02.1933	Rajoc	M	683 dite	13,674,000	200,000	2,048,438	0	0	11,425,562
406	21142	01.07.2009	Qani	Shehu	Mustafa	Aishe	01.05.1890	Korce	M	5 vjet 9 muaj 16 dite	2,778,000	0	0	0	0	2,778,000
407	21212	01.07.2009	Jorgo	Kacani	Tosi	Kato	05.01.1916	Qyteze Korce	M	1 vit 3 muaj 18 dite	952,000	0	480,000	0	0	472,000
408	21225	01.07.2009	Qazim	Vula	Alush	Zyla	08.01.1908	Gjakove	M	D1: 6 vjet 1 muaj 8 dite D2: 11 vjet 11 muaj 28 dite	13,226,000	100,000	2,228,384	0	0	10,897,616

ANEKSI B

Lista nr. 14 e ish të dënuarve, të cilët janë dënuar me dënim kapital																
Nr.	Nr. Dosjes	Data e dosjes individuale	Emër	Mbiemër	Atësi	Amësi	Datëlindja	Vendlindja	Gjinia	Viti i vdekjes	Shuma e dëmshpërbli mit në lekë	Përfitimet nga ligje të mëparshme				Dëmshpërbtmi përfundimtar
												Ministria e Finacës		Enti Kombëtar i Banesave	Z.Q.R.P.P	
												Lekë	Letra me Vlerë			
1	2017	28.02.2008	Kalem	Zogu	Halim	Bajame	03.02.1913	Plashnik,	M	21.01.1947	5,840,000	600,000	720,000	0	0	4,520,000
2	2018	28.02.2008	Dylber	Llapanj	Lile (File)	Fatime	31.12.1895	Xerje, Korçe	M	30.08.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
3	2121	29.02.2008	Habil	Vrako	Rapo	Hane	20.04.1920	Zhulat-	M	12.10.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
4	4434	21.03.2008	Faredin	Jahja	Hysni	Lime	25.01.1922	Maqedoni	M	17.08.1946	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
5	4454	21.03.2008	Hetthem	Lamçe	Banush	Refiko	31.12.1900	Skrapar	M	30.06.1945	5,840,000	200,000	720,000	1,634,000	0	3,286,000
6	5034	01.04.2008	Riza	Isufaj	Heko	Tushe	03.01.1900	Fier	M	15.12.1947	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
7	5296	02.04.008	Shefki	Kreka	Myftar	Alije	31.12.1875	Pogradec	M	25.06.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
8	7582	15.04.2008	Llesh	Mëlyshi	Gjon	Marë	12.10.1898	Rrëshen,	M	16.08.1949	5,840,000	400,000	1,010,630	0	0	4,429,370
9	9326	12.05.2008	Musa	Kërma	Bejo	Beko	1875	Progonat,	M	30.07.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
10	10349	28.05.2008	Çesk	Çoba	Ndoc	Linë	16.03.1922	Shkodër	M	30.03.1954	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
11	11132	13.06.2008	Mihal	Cini	Sotir	Zoica	06.02.1896	Leskovik	M	25.01.1960	11,522,000	200,000	720,000	0	0	10,602,000
12	11469	20.06.2008	Isa	Vrenozi	Veis	Merushë	31.12.1915	Fier	M	20.08.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
13	13695	11.09.2008	Hulusi	Velaj	Amet	Feruze	17.01.1911	Kaninë	M	28.04.1951	5,840,000	0	718,560	0	0	5,121,440
14	14412	09.10.2008	Hariz	Mema	Mine	Sulbena	1900	Gjirokastër	M	30.08.1945	5,840,000	200,000	0	0	0	5,640,000
15	14590	17.10.2008	Dervish	Devishi	Isa	Mine	01.04.1905	Kurtesh,	M	28.05.1945	5,840,000	200,000	718,560	0	0	4,921,440
16	17032	26.12.2008	Sejfulla	Shima	Ramazan	Zyra	23.04.1911	Kruje	M	01.02.1951	9,432,000	400,000	720,000	0	0	8,312,000
17	17362	19.12.2008	Qemal	Kasaruho	Nuri	Xhamfise	24.12.1902	Gjirokaster	M	01.03.1951	5,840,000	2,000,000	0	0	0	3,840,000
18	18029	08.05.2009	Ismail	Sali	Hysa	Fazyle	10.10.1914	Derjan,	M	20.10.1947	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
19	18150	08.05.2009	Ali	Merkaj	Qazim	Mahmude	10.06.1917	Fier	M	1952	5,840,000	0	720,000	0	0	5,120,000
20	19095	08.05.2009	Harito	Bezhani	Leonidha	Vasilqi	19.08.1919	Vlorë	M	18.08.1955	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
21	19265	08.05.2009	Isuf	Pepmarku	Hasan	Hane	12.01.1917	Gjoçaj,	M	18.03.1954	5,840,000	200,000	716,400	0	0	4,923,600
22	19417	08.05.2009	Harallamb	Papa	Nikolla	Ekaterina	10.01.1892	Sarande	M	16.05.1947	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
23	19935	05.06.2009	Koço	Evangelid	Vangjel	Katerina	12.05.1919	Gjirokaster	M	06.09.1946	5,840,000	260,000	720,000	0	0	4,860,000
24	20013	09.06.2009	Bajram	Bajraktari	Nezir	Kadime	27.09.1920	Kukes	M	22.09.1949	5,840,000	200,000	863,342	0	0	4,776,658
25	20016	09.06.2009	Shyqyri	Myftiu	Sadi	Aishe	01.01.1888	Peqin,	M	23.05.1946	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
26	20190	16.06.2009	Nasho	Jorgo	Pando	Maria	08.03.1920	Sopik,	M	12.09.1946	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
27	20206	17.06.2009	Ramiz	Kasa	Nuredin	Hatixhe	01.01.1902	Zihxhafaj	M	20.08.1947	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
28	20214	17.06.2009	Dyle	Voci	Sulejman	Salije	05.04.1898	Vajkal	M	20.05.1946	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
29	20292	22.06.2009	Dalip	Merlika	Haxhi	Mereme	02.02.1911	Kruje	M	31.12.1949	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
30	20348	22.06.2009	Faik	Shehi	Shaqir	Xhabije	10.12.1899	Peshkopi	M	05.02.1948	5,840,000	200,000	0	0	0	5,640,000
31	20362	22.06.2009	Janaq	Dhima	Pandili	Sofi	15.05.1912	Postenan	M	15.05.1912	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
32	20384	24.06.2009	Nevruz	Hysemllari	Riza	Nazime	31.12.1926	Moglice	M	31.12.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
33	20437	24.06.2009	Hysen	Haxhia	Nedim	Naime	31.12.1918	Korçë	M	31.08.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
34	20452	24.06.2009	Hysen	Graceni	Kasem	Hamide	1922	Elbasan	M	28.04.1949	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
35	20713	29.06.2009	Sefedin	Berhamaj	Yzeir	Hava	17.01.1903	Greshice,	M	15.10.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
36	20964	30.06.2008	Enver	Agolli	Ahmet	Zenepe	15.02.1922	Donjanec	M	12.04.1945	5,840,000	200,000	840,000	0	0	4,800,000
37	21063	01.07.2009	Man	Nezaj	Avdi	Zade	05.12.1917	Luzhe,	M	19.11.1949	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
38	21120	01.07.2009	Xhemil	Ruka	Ago	Hane	1905	Smokthin,	M	s'ka	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000

193,952,508

ANEKSI C

Lista nr. 14 e ish te denuareve te cilet kane vlerën 0																
Nr.	Nr. Dosje	Data e dosjes	Emër	Mbiemër	Atësi	Amësi	Datëlindja	Vendlindja	Gjinia	Periudha e plotë e vuajtjes së dënimit	Shuma e dëmshpërblimit në lekë	Përfitimet nga ligje të mëparshme				Dëmshpërbimi përfundimtar
												Ministria e Finacës		Enti Kombëtar i Banesave	Z.Q.R.P.P	
												Lekë	Letra me Vlerë			
1	6818	07.04.2008	Sifi	Mema	Anastas	Lenë	02.09.1928	Elbasan	M	5 m 14 d	338,000	54,904	0	469,000	0	0
2	7940	18.04.2008	Dod	Lulgjuraj	Nikoll	Lulë	12.07.1938	Jugosllavi	M	11 v 11 m 26 d	8,764,000	200,000	12,368,630	1,938,000	0	0
3	10317	28.05.2008	Sulejman	Feto	Dalip	Kike	20.06.1894	Korçë	M	1 vit 3 muaj 8 ditë	932,000	100,000	900,000	0	0	0
4	13294	02.08.2008	Seit	Koprencka	Qazim	Pembe	05.08.1905	Bilisht	M	2vjet 4 muaj 12 dite	1,732,000	60,000	2,820,000	0	85,000	0
5	14275	06.10.2008	Llazi	Papajani	Jani	Sofija	25.02.1901	Kolonjë	M	3 v 10 m 22 d	2,854,000	600,000	3,600,000	0	0	0
6	14336	07.10.2008	Muhamet	Xhaferaj	Xhemal	Bete	07.03.1944	Fier	M	1 muaj, 25 ditë	112,000	0	18,282	899,000	0	0
7	14424	10.10.2008	Mehmet	Xeka	Zeqir	Mahmude	03.04.1923	Durrës	M	0vjet 8 muaj 11 dite	518,000	0	600,000	0	0	0
8	15944	05.12.2008	Fran	Qepuri	Nush	Kaje	10.08.1919	Shkoder	M	277 dite	554,000	100,000	900,000	0	0	0
9	20843	30.06.2009	Qerim	Kasli	Ali	Hane	24.02.1959	Durrës	M	6 muaj, 21 ditë	104,000	100,000	100,000	0	100,000	0

VENDIM
Nr.140, datë 23.2.2011

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
BASHKISË PUKË, TË QARKUT TË SHKODRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Pukë, të qarkut të Shkodrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 92 (nëntëdhjetë e dy) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 491 (katërqind e nëntëdhjetë e një).

2. Pasuria me nr.3, zona kadastrale 3069, pjesë e pronës me numër rendor 5, në listën e inventarit, me sipërfaqe 96 m², t’i kalojë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për privatizim.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Pukë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Pukë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
5, 7-14, 17-21, 28, 34	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative. Pasuria nr.3, zona kadastrale 3069, pjesë e pronës me nr.5 në listën e inventarit, me sipërfaqe 96 m ² , nuk transferohet, t’i kalojë METE-s për privatizim.	Në pronësi
38-47	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
55, 56	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
57-64	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
65-88	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile.	Në pronësi
89	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
90-94	Varrezat publike	Në pronësi
95-101, 111-144, 146-148, 160	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
102-110, 145	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
149-158, 165-166	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
159, 406-419	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi

171-174	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
392-395	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
422-465	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik	Në pronësi

VENDIM
Nr.141, datë 23.2.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KOMSI, TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Koms, të qarkut të Dibrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Koms të qarkut të Dibrës, miratuar me vendimin nr.880, datë 12.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, në komunën Koms, të qarkut të Dibrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Koms për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Koms, Dibrë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-6	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
9, 11-18	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
19-35	Varrezat publike	Në pronësi
36-37, 40-43, 45-47, 50-51, 53-65	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
44	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
70-247	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
38-39, 48-49, 52, 407-409, 411-413, 415, 417-418, 420-421, 423-431, 433-434	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive). Sip. 446 ha, zonë kadastrale 1325, fshati Burrel dhe sip.10 ha, zonë kadastrale 3382, fshati Zall-Shosh, i janë dorëzuar AKKP-së.	Në përdorim

410, 414, 416, 419, 422, 432, 435 436-448	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta) objekte bujqësore	Në pronësi
---	---	------------

VENDIM
Nr.143, datë 23.2.2011

PËR DISA NDRYSHIME DHE NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.961, DATË 18.9.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I SEGMENTIT RRUGOR FUSHË–KRUJË–MILOT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 2 të aktit normativ nr.6, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10 190, datë 26.11.2010 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr.961, datë 18.9.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesa si më poshtë vijon:

- a) Sipërfaqja tokë arë, nga 254 116m² bëhet 251 863m².
- b) Vlera e tokës arë, nga 87 576 435 (tetëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekë, bëhet 86 822 099 (tetëdhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e njëzet e dy mijë e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.
- c) Sipërfaqja tokë truall, nga 15 112m² bëhet 17 255m²,
- ç) Vlera e tokës truall, nga 10 647 900 (dhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet e shtatë mijë e nëntëqind) lekë bëhet 13 528 526 (trembëdhjetë milionë e pesëqind e njëzet e tetë mijë e pesëqind e njëzet e gjashtë) lekë.
- d) Vlera e përgjithshme e shpronësimit, nga 98 224 335 (nëntëdhjetë e tetë milionë e dyqind e njëzet e katër mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lekë bëhet 100 450 625 (njëqind milionë e katërqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) lekë.
- dh) Shtohet sipërfaqja tokë arë prej 754m² vlerësuar me çmimin 352 lekë/m², me vlerë 265 408 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tetë) lekë, në pronësi të Pjetër Mark Përkeqit.

2. Totali i diferencës së kalimit nga tokë arë në truall, prej 2 226 290 (dy milionë e dyqind e njëzet e gjashtë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekësh, dhe shtesa e shpronësimit, prej 265 408 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tetë) lekësh, me një vlerë të përgjithshme prej 2 491 698 (dy milionë e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekësh, do të përballohen nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

3. Likuidimi dhe shpronësimi shtesë të fillojnë më 1.3.2011 dhe të përfundojnë më 1.6.2011.

4. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP-ja”, të kompensohen për diferencën përkatëse të konvertimit të tokës arë në truall dhe të shpronësohen, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afateve të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, si dhe në bazë të dokumentacionit të pronësisë që do të dorëzohet nga pronarët.

6. Brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Kurbin, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në

favor të shtetit. Kjo procedurë do të ndiqet edhe për pasuritë e shpronësuara me vendimin nr.961, datë 18.9.2009 të Këshillit të Ministrave.

7. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Kurbin, të pezullojnë transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në çastin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasurinë e shpronësuar.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Kurbin, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË AUTOSTRADËS “THUMANË-MILOT”

Qarku: LEZHË
Fshati: FUSHË-MAMURRAS

Nr.	Pronari	ZK	Nr. i pas.	Numrat e pasurive sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.961, datë 18.9.2009 dhe pjesa e sipërfaqes që kthehet në truall			Nr. i pasurisë pas procesit të legalizimit	Sipërfaqja, e cila është kthyer në truall dhe që preket nga shpronësimi			Diferenca takuese, duke zbritur masën e kompensimit për pjesën e sipërfaqes që është kthyer nga arë në truall	Shënime
	Emri, mbiemri											
				Sip. m ²	Çmimi m ²	Vlera në lekë		Sip. m ²	Çmimi m ²	Vlera në lekë	Vlera në lekë	
1.	Zenel Hasan Hasanaj	1676	158/48	388	352	136576	158/72	388	1510	585880	449304	Konfirmuar nga ZRPP-ja
2.	Rexhep Lam Hasanaj	1676	158/54	379	352	133408	158/73	379	1510	572290	438882	Konfirmuar nga ZRPP-ja
3.	Beqir Hidriz Hasanaj	1676	158/50	500	352	176000	158/75	500	1510	755000	579000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
4.	Islam Hasan Hasanaj	1676	158/46	500	352	176000	158/70	500	1510	755000	579000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
5.	Gjon Bardhok Bacuku	1676	158/6	266	352	93632	155/14	266	831	221046	127414	Konfirmuar nga ZRPP-ja
6.	Francesk Gjon Bacuku	1676	-	110	352	38720	155/16	110	831	91410	52690	Konfirmuar nga ZRPP-ja
				2143		754336		2143		2980626	2226290	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË AUTOSTRADËS “THUMANË-MILOT”

Qarku: LEZHË
 Fshati: FUSHË-MAMURRAS

Nr.	Pronari	ZK	Nr. i Pasurisë	Arë			Shënime
	Emri, mbiemri			Sip. m ²	Çmimi m ²	Vlera në lekë	
1	Pjetër Mark Perkeqi	1676	216/21	754	352	265408	Konfirmuar nga ZRPP-ja
				754		265408	

VENDIM
Nr.144, datë 23.2.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1269, DATË 17.9.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRBËRJEN, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT DHE DETYRAT E
PËRGJEGJËSITË E STRUKTURAVE SHTETËRORE, TË NGARKUARA PËR
SHQYRTIMIN E VLEFSHMËRISË LIGJORE TË KRIJIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË
MBI TOKËN BUJQËSORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paragrafi i fundit i pikës 2 të shkronjës “A” të kreut III “Përbërja, mënyra e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë (KV)”, të vendimit nr.1269, datë 17.9.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Komisionet vendore prej 3 (tre) anëtarësh duhet të kenë, të paktën, 1 (një) jurist.

Komisionet vendore prej 5 (pesë) anëtarësh duhet të kenë, të paktën, 3 (tre) juristë.

Komisionet vendore prej 6 (gjashtë) anëtarësh duhet të kenë, të paktën, 4 (katër) juristë.

Komisionet vendore prej 7 (shtatë) anëtarësh duhet të kenë, të paktën, 5 (pesë) juristë.”.

2. Ngarkohen prefektët e qarqeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

URDHËR
Nr.24, datë 28.2.2011

PËR SHPALLJEN E NDRYSHIMEVE NË STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË
KONTABILITETIT DHE TË RAPORTIMIT FINANCIAR, TË PËRKTHYER NË GJUHËN
SHQIPE

Në mbështetje të nenit 4, pika 3, të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, në vendimin nr.1, datë 23.12.2010 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit “Për miratimin e ndryshimeve të SNK dhe SNRF për vitin 2010”, të cilat hyjnë në zbatim në vitin 2010 e në vazhdim, të përkthyer në gjuhën shqipe nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe pa u ndryshuar nga teksti origjinal në gjuhën angleze, sipas materialeve bashkëngjitur,

URDHËROJ:

Shpalljen e ndryshimeve për përmirësimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

	Data efektive
1. Ndryshime të SNRF 1 – Adoptimi për herë të parë i SNRF-ve	1 janar 2011
2. Ndryshime në shtojcën D të SNRF 1	
3. Ndryshime të SNRF 3 – Kombinimet e bizneseve	1 korrik 2010
4. Shtojca për ndryshimet në SNRF 3	
5. Ndryshime të SNRF 7 – Instrumentet financiare (dhënia e informacioneve shpjeguese)	1 korrik 2010
6. SNK 32 – Instrumentet financiare (paraqitja)	1 korrik 2010
7. SNK 39 – Instrumentet financiare (njohja dhe matja)	1 korrik 2010
8. Ndryshime në SNK 1 – paraqitja e pasqyrave financiare	1 janar 2011
9. SNK 21 – Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit të monedhave të huaja	1 korrik 2010
10. SNK 28 – Investimet në pjesëmarrje	1 korrik 2010
11. SNK 31 – Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta	1 korrik 2010
12. Ndryshime në SNK 34 – Raportimi financiar i ndërmjetëm	1 janar 2011
13. Ndryshime në KIRFN 13 – Programet e besnikërisë ndaj konsumatorëve	1 korrik 2010
Përjashtim i kufizuar nga dhënia e informacioneve shpjeguese krahasuese sipas SNRF 7 për zbatuesit për herë të parë.	

	Data efektive
1. Ndryshime të SNRF 1 – Zbatimi për herë të parë i SNRF	1 korrik 2010
2. Ndryshime të SNRF 7 – Instrumentet financiare (dhënia e informacioneve shpjeguese)	1 janar 2009
Dhënia e informacioneve shpjeguese, transferimi i aktiveve financiare	
1. Ndryshime të SNRF 7 – Instrumentet financiare (dhënia e informacioneve shpjeguese)	1 korrik 2011
2. Ndryshime të SNRF 1 – Zbatimi për herë të parë i SNRF	1 korrik 2011
Ndryshimet e standardeve bëhen të detyrueshme për zbatim nga data efektive e kalimit e shprehur në Standard. Ato publikohen në Fletoren Zyrtare, faqen e internetit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe të Ministrisë së Financave.	

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit të organizojë punën për botimin e ndryshimeve, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja e lidhur për këtë qëllim, me bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASCF) në Londër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

PËRJASHTIM I KUFIZUAR NGA DHËNIA E INFORMACIONEVE SHPJEGUESE
KRAHASUESE SIPAS SNRF 7 PËR ZBATUESIT PËR HERË TË PARË
(AMENDIM I SNRF 1)

**Amendim i SNRF 1 Zbatimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të
Raportimit Financiar**

Shtohet paragrafi 39C.

Data efektive

39C Përjashtim i Kufizuar nga Dhënia e Informacioneve Shpjeguese Krahasuese sipas SNRF 7 për zbatuesit për herë të parë (amendim i SNRF 1) publikuar në janar 2010, shtoi paragrafin E3. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë amendim për periudhat ushtrimore që fillojnë në ose pas datës 1 korrik 2010. Lejohet zbatimi më i hershëm i këtij amendimi. Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë amendim për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

Shtojca E

Përjashtime afatshkurtra nga SNRF-të

Është shtuar një titull, paragrafi E3 dhe një shënim në fund të faqes.

Dhënie informacionesh shpjeguese për instrumentet financiare

E3 Një zbatues për herë të parë mund të zbatojë dispozitën kalimtare në paragrafin 44G të SNRF 7.*

* Paragrafi E3 u shtua si rrjedhojë e Përjashtimit të Kufizuar nga Dhënia e Informacioneve Shpjeguese Krahasuese sipas SNRF 7 për Zbatuesit për Herë të Parë (amendim i SNRF 1) publikuar në janar 2010. Për të shmangur përdorimin e mundshëm të perceptimeve dhe për të siguruar se zbatuesit për herë të parë nuk janë të disavantazhuar në krahasim me përgatitësit aktualë të SNRF-ve, Bordi vendosi që zbatuesit për herë të parë të lejohen të përdorin të njëjtën dispozitë kalimtare që lejohet për përgatitësit ekzistues të pasqyrave financiare të përgatitura në përputhje me SNRF-të që janë përfshirë në Përmirësimi i Dhënies së Informacioneve Shpjeguese për Instrumentet Financiare (amendime të IFRS 7).

Shtojcë

Amendim i SNRF 7 Instrumentet financiare: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese

Paragrafi 44G është amenduar (teksti i ri pas amendimit është nënvizuar dhe teksti i hequr është mesvizuar) shoqëruar me shënim në fund të faqes.

Data efektive dhe kalimi

44G Përmirësimi i Dhënies së Informacioneve Shpjeguese për Instrumentet Financiare (amendime të SNRF 7), publikuar në mars 2009, amenduan paragrafët 27, 39 dhe B11 dhe shtuan paragrafët 27A, 27B, B10A dhe B11A-B11F. Një njësi ekonomike duhet t'i zbatojë këto amendime për periudhat ushtrimore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2009. ~~Në vitin e parë të zbatimit, një njësi ekonomike nuk ka nevojë të japë informacion krahasues për informacionet shpjeguese të kërkuara nga amendimet për:~~

- a) një periudhë vjetore ose të ndërmjetme, duke përfshirë ndonjë pasqyrë të pozicionit financiar, paraqitur brenda një periudhe vjetore krahasuese që mbaron para datës 31 dhjetor 2009, ose
- b) ndonjë pasqyrë të pozicionit financiar në fillim të periudhës më të hershme krahasuese në një datë para datës 31 dhjetor 2009.

Lejohet zbatimi më i hershëm i këtyre amendimeve. Nëse një njësi ekonomike zbaton këto amendime për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt.*

* Paragrafi 44G u amendua si rrjedhojë e Përgjashtimit Kufizues nga Dhënia e Informacioneve Shpjeguese sipas SNRF 7 për Zbatuesit për Herë të Parë (amendimi i SNRF 1) publikuar në janar 2010. Bordi amendoi paragrafin 44G për të qartësuar konkluzionet e tij dhe kalimin e synuar drejt Përmirësimit të Dhënies së Informacioneve Shpjeguese për Instrumentet Financiare (amendimet e SNRF 7).

DHËNIA E INFORMACIONEVE SHPJEGUESE-TRANSFERIMI I AKTIVEVE FINANCIARE (AMENDIME TË SNRF 7)

Amendime të SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese

Transferimi i aktiveve financiare

42A Kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese në paragrafët 42B–42H të SNRF 7 që lidhen me transferimin e aktiveve financiare shtojnë kërkesa të tjera për dhënie informacionesh shpjeguese të këtij SNRF. Një njësi ekonomike duhet të japë informacionet shpjeguese të kërkuara nga paragrafët 42B–42H në një shënim shpjegues të vetëm të pasqyrave të saj financiare. Një njësi ekonomike duhet të sigurojë dhënien e kërkuar të informacioneve shpjeguese për të gjitha aktivet financiare të transferuara që nuk janë çregjistruar, si dhe për çdo përfshirje të vazhdueshme në një aktiv të transferuar, që ekziston në datën e raportimit, pavarësisht se kur ka ndodhur veprimi përkatës i transferimit. Me qëllim zbatimin e kërkesave për dhënie informacionesh shpjeguese në këta paragrafë, një njësi ekonomike transferon të gjithë ose një pjesë të aktivit financiar (aktivit financiar të transferuar), nëse dhe vetëm nëse, ajo:

a) transferon të drejtat kontraktuale për të marrë flukse mjjetesh monetare të atij aktivit financiar; ose

b) mban të drejtat kontraktuale për të marrë flukse mjjetesh monetare të atij aktivit financiar, por merr përsipër (njeh) një detyrim kontraktual për të paguar flukse mjjetesh monetare të një ose më shumë palë të tjera në një marrëveshje.

42B Një njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese që i mundëson përdoruesve të pasqyrave të saj financiare:

a) të kuptojnë lidhjen midis aktiveve financiare të transferuara, të cilat nuk janë çregjistruar në tërësinë e tyre dhe detyrimeve të lidhura me to; dhe

b) të vlerësojnë natyrën dhe rreziqet që shoqërojnë përfshirjen e vazhdueshme të njësisë ekonomike në aktivet e çregjistruara financiare.

42C Me qëllim zbatimin e kërkesave për dhënie informacionesh shpjeguese në paragrafët 42E–42H, një njësi ekonomike ka përfshirje të vazhdueshme në një aktiv financiar të transferuar nëse, si pjesë e transferimit, njësi ekonomike mban ndonjë nga të drejtat ose detyrimet kontraktuale të lidhura me aktivin financiar të transferuar ose merr ndonjë të drejtë të re ose detyrim të ri që lidhet me aktivin financiar të transferuar. Me qëllim zbatimin e kërkesave për dhënie informacionesh shpjeguese në paragrafët 42E–42H, elementet e mëposhtme nuk përbëjnë përfshirje të vazhdueshme:

a) Paraqitjet normale dhe garancitë që lidhen me transferimin mashtrues dhe konceptet e arsyeshmërisë, mirëbesimit dhe marrëveshjeve të sinqerta që mund të shfuqizojnë një transferim si rezultat i një veprimi ligjor;

b) Kontratat e së ardhmes, opsionet dhe kontrata të tjera për të riblerë aktivin financiar të transferuar për të cilin çmimi i kontratës (ose çmimi i ushtrimit të opsionit) është vlera e drejtë e aktivit financiar të transferuar; ose

c) Një marrëveshje sipas së cilës një njësi ekonomike mban të drejtat kontraktuale për të marrë flukse mjjetesh monetare të një aktivit financiar, por merr përsipër një detyrim kontraktual për të paguar flukse mjjetesh monetare të një ose më shumë njësi ekonomike dhe plotësohen kushtet e paragrafëve 19(a)–(c) të SNK 39.

Aktivitet financiar të transferuara që nuk janë çregjistruar në tërësinë e tyre

42D Një njësi ekonomike mund të ketë transferuar aktive financiare në një mënyrë të tillë që pjesë ose të gjitha aktivet financiare të transferuara nuk kualifikohen për çregjistrim. Për të plotësuar objektivat e vendosur në paragrafët 42B(a), njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues në çdo datë raportimi për çdo klasë të aktiveve financiare të transferuara që nuk janë çregjistruar në tërësinë e tyre për:

- a) natyrën e aktiveve të transferuara.
- b) natyrën e rreziqeve dhe përfitimeve që lidhen me titullin e pronësisë së aktiveve të transferuara dhe që ndaj të cilave është e ekspozuar njësia ekonomike.
- c) një përshkrim të natyrës së marrëdhënieve midis aktiveve të transferuara dhe detyrimeve të lidhura me to, duke përfshirë kufizimet që vijnë nga transferimi në përdorim i aktiveve të transferuara për njësinë ekonomike raportuese.
- d) kur pala tjetër (palët e tjera) që lidhet me detyrimet ka të drejtë vetëm ndaj aktiveve të transferuara, një pasqyrë që tregon llogaritjet e vlerës së drejtë të aktiveve të transferuara, të vlerës së drejtë të detyrimeve që lidhen me to dhe të pozicionit neto (diferenca midis vlerës së drejtë të aktiveve të transferuara dhe detyrimeve të lidhura me to).
- e) kur njësia ekonomike vazhdon të njohë të gjitha aktivet e transferuara, vlerën kontabël të aktiveve të transferuara dhe të detyrimeve të lidhura me to.
- f) kur njësia ekonomike vazhdon të njohë aktivet në nivelin e përfshirjes së saj të vazhdueshme (shiko paragrafët 20(c)(ii) dhe 30 të SNK 39), vlerën totale kontabël të aktiveve origjinale para transferimit, vlerën kontabël të aktiveve që njësia ekonomike vazhdon të njohë, dhe vlerën kontabël të detyrimeve që lidhen me to.

Aktivitet financiar të transferuara që janë çregjistruar në tërësinë e tyre

42E Për të arritur objektivat e vendosur në paragrafin 42B(b), kur një njësi ekonomike çregjistron aktivet financiare të transferuara në tërësinë e tyre (shiko paragrafët 20(a) dhe (c)(i) të SNK 39), por ka përfshirje të vazhdueshme në to, njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për çdo lloj të përfshirjes së vazhdueshme në çdo datë raportimi, minimumi për:

a) vlerën kontabël të mbartur të aktiveve dhe detyrimeve që janë njohur në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike dhe përfaqësojnë përfshirjen e vazhdueshme të saj në aktivet e çregjistruara financiare, dhe pozicionet (zërat e pasqyrës), në të cilat vlera kontabël e këtyre aktiveve dhe detyrimeve është njohur.

b) vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve që përfaqësojnë përfshirjen e vazhdueshme të njësisë ekonomike në aktivet e çregjistruara financiare.

c) vlerën që përfaqëson më mirë ekspozimin maksimal të njësisë ekonomike ndaj humbjes nga përfshirja e vazhdueshme në aktivet financiare të çregjistruara, dhe informacionin që tregon se si përcaktohet ky ekspozim.

d) flukset dalëse të mjeteve monetare të paskontuara që mund të kërkohen ose do të kërkoheshin për të riblerë aktivet financiare të çregjistruara (p.sh. çmimi i përcaktuar në një marrëveshje opsioni) ose shumat e tjera të pagueshme për palën ku janë transferuar aktivet. Nëse flukset dalëse të mjeteve monetare janë variabël atëherë shumat e paraqitura në informacionet shpjeguese duhet të bazohet në kushtet që ekzistojnë në çdo datë bilanci.

e) një analizë të afatit të maturimit të flukseve dalëse të mjeteve monetare të paskontuara që mund të kërkohen ose do të kërkoheshin për të riblerë aktivet financiare të çregjistruara ose të shumave të tjera të pagueshme për palën ku janë transferuar aktivet, duke treguar afatet kontraktuale të mbetura deri në maturim të përfshirjes së vazhdueshme të njësisë ekonomike.

f) informacionin cilësor që shpjegon dhe mbështet dhënien e informacioneve shpjeguese sasiore të kërkuara në (a)–(e).

42F Një njësi ekonomike mund të bashkojë informacionin e kërkuar nga paragrafi 42E në lidhje me një aktiv të veçantë nëse njësia ekonomike ka më shumë se një lloj të përfshirjes së vazhdueshme në atë aktiv financiar të çregjistruar dhe e raporton atë sipas një lloji të përfshirjes së vazhdueshme.

42G Gjithashtu, një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për çdo lloj të përfshirjes së vazhdueshme për:

a) fitimin ose humbjen e njohur në datën e transferimit të aktiveve.

b) të ardhurat dhe shpenzimet e njohura në periudhën raportuese dhe të akumuluar, nga përfshirja e vazhdueshme në aktivet financiare të çregjistruara (p.sh. ndryshimet në vlerën e drejtë të derivativëve).

c) nëse vlera totale e shumave të arkëtuara nga aktiviteti i transferimit (që kualifikohen për çregjistrim) në një periudhë raportuese nuk është shpërndarë ende përgjatë periudhës (p.sh. nëse një pjesë e konsiderueshme e vlerës totale nga aktiviteti i transferimit është arkëtuar ditët e fundit të periudhës raportuese):

i) kur aktiviteti më i madh i transferimit ka ndodhur brenda asaj periudhe raportuese (p.sh. pesë ditë para fundit të periudhës raportuese),

ii) shumat (p.sh. fitimet ose humbjet përkatëse) e njohura nga aktiviteti i transferimit në atë pjesë të periudhës raportuese, dhe

iii) vlerën totale të arkëtimeve nga aktiviteti i transferimit në atë pjesë të periudhës raportuese.

Një njësi ekonomike duhet ta japë këtë informacion për çdo periudhë për të cilën paraqitet një pasqyrë përmblledhëse e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Informacion shtesë

42H Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për çdo informacion shtesë që ajo e konsideron të nevojshëm për të plotësuar objektivat në lidhje me dhënien e informacioneve shpjeguese në paragrafin 42B.

Data efektive dhe periudha kalimtare

Shtohet paragrafi 44M.

44M *Dhënia e informacioneve shpjeguese — Transferimi i aktiveve financiare* (amendime të SNRF 7), publikuar në tetor 2010 hoqi paragrafin 13 dhe shtoi paragrafët 42A–42H dhe B29–B39. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto amendime për periudhat ushtrimore që fillojnë në ose pas datës 1 korrik 2011. Lejohet zbatimi më i hershëm i këtyre amendimeve. Nëse një njësi ekonomike zbaton amendimet në një datë më të hershme, ajo duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt. Një njësi ekonomike nuk ka nevojë të japë informacione shpjeguese të kërkuara nga këto amendime për çdo periudhë që fillon përpara datës së zbatimit fillestar të amendimeve.

Shtojca B Udhëzime për zbatim

Pas paragrafit B28, shtohen nëntitujt dhe paragrafët B29–B39

Çregjistrimi (paragrafët 42C–42H)

Përfshirja e vazhdueshme (paragrafi 42C)

B29 Vlerësimi i përfshirjes së vazhdueshme në një aktiv financiar të transferuar sipas kërkesave për dhënien e informacioneve shpjeguese në paragrafët 42E–42H bëhet në nivel të njësisë ekonomike raportuese. Për shembull, nëse një njësi e kontrolluar (filial) transferon te një palë e tretë e palidhur, një aktiv financiar në të cilin njësia kontrolluese (mëma) ka përfshirje të vazhdueshme, njësia e kontrolluar (filiale) nuk e merr parasysh përfshirjen e njësisë kontrolluese (mëmës) në vlerësimin nëse vetë ajo ka përfshirje të vazhdueshme në aktivin e transferuar në pasqyrat e saj financiare individuale (p.sh. kur njësia e kontrolluar (filiale) është njësi raportuese). Megjithatë, një njësi kontrolluese (mëmë) do ta merrte parasysh përfshirjen e saj të vazhdueshme (ose përfshirjen e vazhdueshme të ndonjë njësie tjetër brenda grupit) në një aktiv financiar të transferuar nga njësia e kontrolluar prej saj në përcaktimin nëse ajo ka përfshirje të vazhdueshme në aktivin e transferuar në pasqyrat financiare të konsoliduara (p.sh. kur njësia raportuese është grupi).

B30 Një njësi ekonomike nuk ka një përfshirje të vazhdueshme në një aktiv financiar të transferuar, nëse, si pjesë e transferimit, ajo as nuk mban ndonjë nga të drejtat ose detyrimet kontraktuale, të lidhura me aktivin financiar të transferuar, as nuk blen të drejta apo detyrime kontraktuale të reja që lidhen me aktivin financiar të transferuar. Një njësi ekonomike nuk ka përfshirje të vazhdueshme në një aktiv financiar të transferuar, nëse ajo nuk ka as interes në performancën e ardhshme të aktivit financiar të transferuar, as përgjegjësi në ndonjë rrethanë për të bërë pagesa në të ardhmen në lidhje me aktivin financiar të transferuar.

B31 Përfshirja e vazhdueshme në një aktiv financiar të transferuar mund të lindë nga parashikimet kontraktuale në marrëveshjen e transferimit ose në një marrëveshje të veçantë me palën ku është bërë transferimi ose me një palë të tretë që ka hyrë në aktivitetin e transferimit.

Aktivet financiare të transferuara që nuk janë çregjistruar në tërësinë e tyre

B32 Paragrafi 42D kërkon dhënien e informacioneve shpjeguese kur pjesë ose të gjitha aktivet financiare të transferuara nuk kualifikohen për çregjistrim. Këto informacione shpjeguese kërkojnë në çdo datë raportimi në të cilat njësia ekonomike vazhdon të njohë aktivet financiare të transferuara, pavarësisht kur ka ndodhur transferimi.

Llojet e përfshirjes së vazhdueshme (paragrafët 42E–42H)

B33 Paragrafët 42E–42H kërkojnë dhënien e informacioneve shpjeguese cilësore dhe sasiore për çdo lloj të përfshirjes së vazhdueshme në aktivet financiare të çregjistruara. Një njësi ekonomike duhet t'i bashkojë përfshirjet e saj të vazhdueshme në lloje, që janë përfaqësues të ekspozimeve të njësisë ekonomike ndaj rreziqeve. Për shembull, një njësi ekonomike mund t'i bashkojë përfshirjet e saj të vazhdueshme sipas llojit të instrumentit financiar (p.sh. garancitë ose opsionet për blerje) ose sipas llojit të transferimit (p.sh. shitja e llogarive të arkëtueshme-factoringu, përgatitja e letrave me vlerë për tregtim dhe huazimi i letrave me vlerë).

Analiza e maturimit të flukseve dalëse të mjeteve monetare të paskontuara për të riblerë aktivet e transferuara (paragrafi 42E(e))

B34 Paragrafi 42E(e) kërkon që një njësi ekonomike të japë informacione shpjeguese për një analizë maturimi të flukseve dalëse të mjeteve monetare të paskontuara për të riblerë aktivet financiare të çregjistruara ose të shumave të tjera të pagueshme për palën ku është bërë transferimi i aktiveve financiare të çregjistruara, duke treguar afatet kontraktuale të mbetura deri në maturim të përfshirjes së vazhdueshme të njësisë ekonomike. Kjo analizë dallon flukset e mjeteve monetare që kërkojnë të paguhet (p.sh. kontratat e së ardhmes), flukset e mjeteve monetare që njësia ekonomike mund të kërkojë të paguajë (p.sh. opsionet e nënshkruara për shitje) dhe flukset e mjeteve monetare që njësia ekonomike mund të zgjedhë për të paguar (p.sh. opsionet e blera për blerje).

B35 Një njësi ekonomike duhet të përdorë gjykimin e saj për të përcaktuar një numër të përshtatshëm të hapësirave kohore kur përgatit analizën e afatit të maturimit, kërkuar nga paragrafi 42E(e). Për shembull, një njësi ekonomike mund të përcaktojë se hapësirat e mëposhtme të afateve të maturimit janë të përshtatshme:

- a) deri në një muaj;
- b) nga një deri në tre muaj;
- c) nga tre deri në gjashtë muaj;
- d) nga gjashtë muaj deri në një vit;
- e) nga një deri në tre vjet;
- f) nga tre deri në pesë vjet; dhe
- g) më shumë se pesë vjet.

B36 Nëse ka një diapazon të afateve të mundshme të maturimit, flukset e mjeteve monetare përfshihen (grupohen) në bazë të datës më të hershme në të cilën njësia ekonomike mund të kërkojë ose lejohet të paguajë.

Informacioni cilësor (paragrafi 42E(f))

B37 Informacioni cilësor i kërkuar nga paragrafi 42E(f) përfshin një përshkrim të aktiveve financiare të çregjistruara, si dhe natyrën dhe qëllimin e përfshirjes që vazhdon të mbahet edhe pas transferimit të këtyre aktiveve. Ai përfshin, gjithashtu, një përshkrim të rreziqeve ndaj të cilave një njësi ekonomike është e ekspozuar, duke përfshirë:

a) një përshkrim se si e administron njësia ekonomike rrezikun e vetvetishëm në përfshirjen e saj të vazhdueshme në aktivet financiare të çregjistruara;

b) nëse njësia ekonomike kërkojë t'i mbartë humbjet përpara palëve të tjera, renditjen dhe shumat e humbjeve që vijnë nga palët, interesi i të cilave renditet më poshtë se interesi i njësisë ekonomike mbi aktivin (p.sh. përfshirja e saj e vazhdueshme mbi aktivin);

c) një përshkrim të çdo mekanizmi të lidhur me detyrimet për të siguruar mbështetje financiare ose për të riblerë një aktiv financiar të transferuar.

Fitimet ose humbjet nga çregjistrimi (paragrafi 42G(a))

B38 Paragrafi 42G(a) kërkon që një njësi ekonomike të japë informacion shpjegues për fitimet ose humbjet nga çregjistrimi i aktiveve financiare në të cilat njësia ekonomike ka përfshirje të vazhdueshme. Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues nëse një fitim ose një humbje ka lindur, sepse vlera e drejtë e elementeve përbërëse të aktivitetit të njohur më parë (p.sh. interesi mbi aktivin e çregjistruar dhe interesi i mbajtur nga njësia ekonomike) ndryshonin nga vlera e drejtë e aktivitetit të njohur më parë si një i tërë. Në këtë situatë, njësia ekonomike duhet të japë, gjithashtu, informacion shpjegues nëse vlerësimi i vlerës së drejtë përfshinte të dhëna të rëndësishme që nuk ishin bazuar në të dhënat e vëzhgueshme të tregut, siç përshkruhet në paragrafin 27A.

Informacion shtesë (paragrafi 42H)

B39 Dhënia e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga paragrafët 42D–42G, mund të mos jetë e mjaftueshme për të plotësuar objektivat mbi dhënien e informacioneve shpjeguese në paragrafin 42B. Në këtë rast, njësia ekonomike duhet të shpjegojë çfarëdolloj informacioni shtesë që është i nevojshëm për të plotësuar objektivat mbi dhënien e informacioneve shpjeguese. Njësia ekonomike duhet të vendosë, në dritën e rrethanave të saj, sa informacion shtesë ka nevojë të sigurojë për të plotësuar nevojat për informacion të përdoruesve dhe se sa theks vendos në aspektet e ndryshme të informacionit shtesë. Është e nevojshme të vendosim një balancë midis ngarkesës së pasqyrave financiare me informacion shtesë që nuk mund t'i ndihmojë përdoruesit e pasqyrave financiare dhe fshehjes së informacionit si rezultat i shumë bashkimeve.

Amendim i SNRF 1 Zbatimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

Shtohet paragrafi 39F

Data efektive

39F *Dhënia e Informacioneve Shpjeguese — Transferime të Aktiveve Financiare* (amendime të SNRF 7), publikuar në tetor 2010, shtoi paragrafin E4. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë amendim për periudhat ushtrimore që fillojnë në ose pas datës 1 korrik 2011. Lejohet zbatimi më i hershëm i këtij amendimi. Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë amendim për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

Shtojca E Përgjashtime afatshkurtra nga SNRF-të

Është shtuar paragrafi E4 dhe një shënim në fund të faqes.

Dhënia e informacioneve shpjeguese për instrumentet financiare

E4 Një zbatues për herë të parë i SNRF mund të zbatojë dispozitën kalimtare në paragrafin 44M të SNRF 7. *

* Paragrafi E4 u shtua si rrjedhojë e amendimeve të SNRF 7 *Dhënia e Informacioneve Shpjeguese—Transferime të Aktiveve Financiare*, publikuar në tetor 2010. Për të shmangur përdorimin e mundshëm të perceptimeve dhe për të siguruar se zbatuesit për herë të parë nuk janë të disavantazhuar në krahasim me hartuesit sipas SNRF-ve aktuale, Bordi vendosi që zbatuesit për herë të parë të lejohen të përdorin të njëjtën dispozitë kalimtare që lejohet për hartuesit ekzistues të pasqyrave financiare të përgatitura në përputhje me SNRF-të që janë përfshirë në *Dhënia e Informacioneve Shpjeguese – Transferime të Aktiveve Financiare* (amendime të IFRS 7).

Përmirësimet në SNRF-të

Amendime në SNRF 1 *Adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për herë të parë*

Paragrafët 27 dhe 32 janë ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe tekstit të fshirë i është hequr një vizë). Janë shtuar: paragrafi 27A, një titull dhe paragrafët 31B dhe 39E.

Paraqitja dhe dhënia e informacionit shpjegues

27 SNK 8 nuk ka të bëjë zbatohet për ndryshimet në politikat kontabël që ndodhin kur që një njësi ekonomike ndërmerr kur së pari adopton SNRF-të ose për ndryshimet në ato politika deri sa ajo paraqet pasqyrat e para financiare sipas SNRF-ve. Prandaj, kërkesat e SNK 8 ~~për dhënien e informacioneve shpjeguese~~ në lidhje me ndryshimet në politikat kontabël nuk zbatohen në pasqyrat e para financiare sipas SNRF-ve të një njësie ekonomike.

27A Në qoftë se gjatë periudhës së mbuluar nga pasqyrat e para financiare, sipas SNRF-ve një njësi ekonomike ndryshon politikat kontabël ose përdorimin e përjashtimeve të tyre të dhëna në këtë SNRF, ajo do të shpjegojë ndryshimet mes raportit të parë financiar të ndërmjetëm sipas SNRF-ve dhe pasqyrave të saj të para financiare sipas SNRF-ve, në përputhje me paragrafin 23, dhe do të përditësojë rakordimet e kërkuara nga paragrafi 24(a) dhe (b).

Përdorimi i kostos së supozuar për veprimtaritë që i nënshtrohen rregullimit të tarifës

31B Nëse një njësi ekonomike përdor përjashtimin në paragrafin D8B për veprimtaritë që u nënshtrohen rregullimit të tarifës, ajo duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe për bazën mbi të cilën ishin përcaktuar vlerat kontabël neto sipas PPPK-së të mëparshëm.

Raportet financiare të ndërmjetme

32 Në përputhje me paragrafin 23, në qoftë se një njësi ekonomike paraqet një raport financiar të ndërmjetëm në përputhje me SNK 34 për pjesë të periudhës së mbuluar nga pasqyrat e para financiare sipas SNRF-ve, njësia ekonomike do të plotësojë përveç kërkesave të SNK 34 edhe kërkesat e mëposhtme:

a) Çdo raport financiar i ndërmjetëm, nëse njësia ekonomike ka paraqitur një raport të tillë financiar të ndërmjetëm për periudhën e krahasueshme menjëherë pas vitit financiar të mëparshëm, do të përfshijë:

i) një rakordim të kapitalit neto të saj në përputhje me PPPK-në e mëparshëm në fund të kësaj periudhe të përkohshme të krahasueshme me kapitalin neto sipas SNRF-ve në këtë datë; dhe

ii) një rakordim të shumës të të ardhurave të gjithëpërfshirëse të saj në përputhje me SNRF-të për atë periudhë të ndërmjetme të krahasueshme (që nga fillimi i vitit e deri në momentin aktual). Pika e fillimit për këtë rakordim do të jenë të ardhurat totale gjithëpërfshirëse në përputhje me PPPK-në e mëparshëm për atë periudhë, ose, në qoftë se një njësi ekonomike nuk ka një raport të tillë, fitimi ose humbja totale në përputhje me PPPK-në e mëparshëm.

b) Përveç rakordimeve të kërkuara nga (a), raporti i parë financiar i ndërmjetëm i një njësie ekonomike në përputhje me SNK 34 për pjesë të periudhës së mbuluar nga pasqyrat e para financiare sipas SNRF-ve, duhet të përfshijë rakordimet e përshkruara në paragrafin 24 (a) dhe (b) (plotësuar me të dhënat e kërkuara nga paragrafët 25 dhe 26) ose referencat e kryqëzuara në një tjetër dokument të botuar që përfshin këto rakordime.

c) Nëse një njësi ekonomike ndryshon politikat e saj kontabël ose përdorimin e përjashtimeve të tyre që jeten në këtë SNRF, ajo do të shpjegojë ndryshimet në çdo raport financiar të tillë të ndërmjetëm në përputhje me paragrafin 23 dhe do të përditësojë rakordimet e kërkuara nga (a) dhe (b).

Data e hyrjes në fuqi

39E Si rezultat i *Përmirësimeve* në SNRF-të e publikuara në maj 2010 janë shtuar paragrafët 27A, 31B dhe D8B dhe janë ndryshuar paragrafët 27, 32, D1 (c) dhe D8. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2011 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon para datës në 1 janar 2011, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Njësitë ekonomike që kanë adoptuar SNRF-të në periudhat para datës së hyrjes në fuqi të SNRF 1 ose kanë zbatuar SNRF 1 në një periudhë të mëparshme janë të lejuara të zbatojnë ndryshimin në paragrafin D8 në mënyrë retrospektive për periudhën e parë vjetore, pasi ndryshimi ka hyrë në fuqi. Një njësi ekonomike që zbaton paragrafin D8 në mënyrë retrospektive duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

Amendime në shtojcën D të SNRF 1 Adaptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për herë të parë

Paragrafët D1(c) dhe D8 janë ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe tekstit të fshirë i është vënë viza) dhe është shtuar paragrafi D8B.

D1 Një njësi ekonomike mund të zgjedhë të përdorë një ose më shumë nga përjashtimet e mëposhtme:

...

c) koston e supozuar (paragrafët D5–D8A–B);

...

Kosto e supozuar

D8 Një adoptues për herë të parë mund të ketë krijuar një kosto të supozuar në përputhje me PPPK-në e mëparshëm për disa ose të gjitha aktivet dhe detyrimet e tij duke i matur ato me vlerën e drejtë në një datë të veçantë për shkak të një ngjarjeje të tillë si një privatizim apo ofertë publike fillestare. ~~Ajo~~

a) Nëse data e matjes është në ose para datës së kalimit në SNRF-të, njësia ekonomike mund të përdorë matjet e vlerës së drejtë të shkaktuar nga një ngjarje e tillë si kosto të supozuar për SNRF-të në datën e kësaj matjeje.

b) Nëse data e matjes është pas datës së kalimit në SNRF-të, por gjatë periudhës së mbuluar nga pasqyrat e para financiare sipas SNRF-ve, matjet e vlerës së drejtë për shkak të ngjarjes mund të përdoren si kosto e supozuar, kur ngjarja ndodh. Një njësi ekonomike do të njohë rregullimet që rezultojnë drejtpërdrejt në fitimet e pashpërndara (ose nëse është e përshtatshme, në një tjetër kategori të kapitalit neto) në datën e matjes. Në datën e kalimit në SNRF-të, njësia ekonomike do të përcaktojë koston e supozuar duke zbatuar kriteret e paragrafëve D5–D7 ose do të masë aktivet dhe detyrimet në përputhje me kërkesat e tjera në këtë SNRF.

D8B Disa njësi ekonomike mbajnë zëra të aktiveve afatgjata materiale ose aktiveve jomateriale që përdoren, ose janë përdorur më parë, në veprimtaritë që i nënshtrohen rregullimit të tarifës. Vlera kontabël neto e zërave të tillë mund të përfshijë shumat që ishin të vendosura sipas PPPK-ve të mëparshme, por nuk kualifikohen për kapitalizim në përputhje me SNRF-të. Nëse është ky rast, një adoptues për herë të parë, mund të zgjedhë të përdorë si kosto të supozuar vlerën kontabël neto të mëparshme sipas PPPK-së, të një zëri të tillë në datën e kalimit sipas SNRF-ve. Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë përjashtim për një zë, ajo nuk duhet ta zbatojë atë në të gjitha zërat. Në datën e kalimit sipas SNRF-ve, një njësi ekonomike do të testojë për zhvlerësim në përputhje me SNK 36 secilin zë për të cilin është përdorur ky përjashtim. Për qëllimet e këtij paragrafi, veprimtaritë janë subjekt i rregullimit të tarifës, në qoftë se ato ofrojnë mallra apo shërbime për konsumatorët me çmime (d.m.th. tarifa), të përcaktuara nga një organ i autorizuar për të vendosur tarifa që janë detyruese konsumatorët dhe që janë projektuar për të mbuluar kostot specifike që bën njësia ekonomike për të ofruar mallrat ose shërbimet e rregulluara ose dhe për të fituar një kthim të specifikuar. Kthimi i specifikuar mund të jetë një minimum ose varg dhe nuk ka nevojë të jetë një kthim fiks ose i garantuar.

Amendime në SNRF 3 Kombinimet e biznesit

Paragrafi 19, titulli para paragrafit 30 dhe paragrafi 30 janë ndryshuar (tekst i ri është nënvizuar dhe tekstit të fshirë i është vënë viza). Paragrafët 64B, 64C dhe 65A–65E janë shtuar.

Metoda e blerjes

Parimi i matjes

19 Për çdo kombinim biznesi, blerësi do të matë në datën e blerjes përbërësit e ndonjë interesave jokontrrollues në njësinë e blerë që përfaqësojnë interesat e pronësisë dhe të drejtën e mbajtësit për një pjesë proporcionale në aktivet neto të njësisë ekonomike në rast likuidimi me ose në vlerën e drejtë ose në pjesë proporcionale të interesit jokontrrollues në aktivet neto të identifikueshme të njësisë së blerë

a) vlerën e drejtë; ose

b) pjesën proporcionale të instrumenteve të pronësisë aktuale në shumat e njohura të aktiveve neto të identifikueshme të njësisë së blerë.

Të gjithë përbërësit e tjerë të interesave jokontrrolluese do të maten me vlerat e drejta në datën e tyre të blerjes, përveç nëse një bazë tjetër matjeve është kërkuar nga SNRF-të.

Përrjashtime nga parimet e njohjes apo të matjes

Përrjashtime nga parimi i matjes

Transaksionet e pagesës çmimet me aksione

30 Blerësi do të matë një detyrim ose një instrument kapitali të lidhur me transaksionet e pagesës së bazuar në aksione të njësisë së blerë ose zëvendësimin e transaksioneve të pagesës çmimeve me aksione të një njësie të blerë me transaksionet çmimet e pagesës të bazuar në aksione së blerësit në përputhje me metodën në SNRF 2 *Pagesat e bazuara në aksione në datën e blerjes*. (Ky SNRF i referohet rezultatit të kësaj metode si “matje e bazuar në treg” të çmimit transaksionit të pagesës të bazuar në aksione).

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

Data e hyrjes në fuqi

64B Si rezultat i *Përmirësimeve në SNRF-të* e publikuara në maj 2010 janë ndryshuar paragrafët 19, 30 dhe B56 dhe janë shtuar paragrafët B62A dhe B62B. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë 1 korrik 2010 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë para datës 1 korrik 2010, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt. Zbatimi do të jetë në mënyrë prospektive nga data kur njësia ekonomike ka zbatuar për herë të parë këtë SNRF.

64C Me *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2010 janë shtuar paragrafët 65A-65E. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2010 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë para datës 1 korrik 2010, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt. Ndryshimet do të zbatohen në tepricat eventuale që lindin nga kombinimet e biznesit me një datë të blerjes para zbatimit të këtij SNRF, të publikuar në 2008-ën.

Periudha kalimtare

65A Tepricat eventuale që rrjedhin nga kombinimet e biznesit datat e të cilave i paraprijnë datës kur një njësi ekonomike ka zbatuar për herë të parë këtë SNRF të publikuar në 2008, nuk do të rregullohen në bazë të zbatimit për herë të parë të këtij SNRF-je. Për këto teprica në kontabilitetin e mëpasshëm do të zbatohen paragrafët 65B-65E. Paragrafët 65B-65E nuk do të zbatohen për kontabilizimin e tepricave eventuale që lindin nga kombinimet e biznesit me data të blerjes në ose pas datës kur njësia ekonomike ka zbatuar për herë të parë këtë SNRF publikuar në 2008. Në paragrafët 65B-65E kombinim i biznesit i referohet ekskluzivisht kombinimeve të biznesit, datat e blerjes së të cilave i paraprijnë zbatimit të këtij SNRF të publikuara në 2008-ën.

65B Në qoftë se marrëveshja e një kombinimi biznesi parashikon një rregullim në koston e kombinimit, të varur nga ngjarjet e ardhshme, blerësi do të përfshijë shumën e këtij rregullimi në koston e kombinimit në datën e blerjes, nëse rregullimi është i mundur dhe mund të matet me besueshmëri.

65C Një marrëveshje kombinimi biznesi mund të lejojë rregullime në koston e kombinimit, të cilat varen nga një ose më shumë ngjarje në të ardhmen. Për shembull, rregullimi mund të kushtëzohet nga një nivel i caktuar i fitimit të mbajtur ose të arritur në periudhat e ardhshme, apo nga çmimi i tregut i instrumenteve të emetuara që janë duke u mbajtur. Zakonisht është e mundur të vlerësohet

shuma e çdo rregullimi të tillë në kohën e kontabilizimit fillestar të kombinimit, pa dëmtuar besueshmërinë e informacionit, edhe pse ekzistojnë disa pasiguri. Në qoftë se ngjarjet nuk do të ndodhin në të ardhmen apo vlerësimi kërkon të rishikohet, kostoja e kombinimit të biznesit do të rregullohet në përputhje me rrethanat.

65D Megjithatë, kur një marrëveshje kombinim biznesi parashikon një rregullim të tillë, atëherë rregullimi nuk përfshihet në koston e kombinimit në kohën e kontabilizimit fillestar të tij nëse ai ose nuk është i mundshëm, ose nuk mund të matet me besueshmëri. Në qoftë se më pas, rregullimi bëhet i mundshëm dhe mund të matet me besueshmëri, shuma shtesë do të trajtohet si një rregullim në koston e kombinimit.

65E Në disa rrethana, blerësi e ka të nevojshme t'i bëjë një pagesë të mëvonshme shitësit, si kompensim për një reduktim në vlerën e aktiveve të dhëna, instrumenteve të kapitalit neto të emetuar ose detyrimeve të kryera apo të marra përsipër nga blerësi në këmbim të kontrollit të njësisë së blerë. Ky është rasti, kur për shembull, blerësi garanton çmimin e tregut të kapitalit apo borxhit të emetuar, si pjesë e koston së kombinimit të biznesit dhe është e nevojshme të emetohet kapital shtesë ose instrumente borxhi për të rivendosur koston e përcaktuar fillimisht. Në raste të tilla, nuk njihet rritje në koston e kombinimit të biznesit. Në rastin e instrumenteve të kapitalit neto, vlera e drejtë e pagesës shtesë kompensohet me një reduktim të barabartë në vlerën e caktuar të instrumenteve të emetuara fillimisht. Në rastin e instrumenteve të borxhit, pagesa shtesë konsiderohet si një zvogëlim i primit ose një rritje e zbritjes në emetimin fillestar.

Udhëzues për zbatim

Në shtojcën B, paragrafi B56 është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe tekstit të fshirë i është vënë viza) dhe janë shtuar: një shënim në paragrafin B56, një titull pas paragrafit B62 dhe paragrafët B62A dhe B62B.

Përcaktimi se çfarë është pjesë e transaksionit të kombinimit të biznesit (zbatimi i paragrafëve 51 dhe 52)

Pagesa e bazuar në aksionet e blerësit në këmbim të shpërblimeve që u takojnë punonjësve të njësisë së blerë (zbatimi i paragrafit 52 (b))

B56 Një blerës mund të këmbëjë shpërblimet¹ në pagesa të bazuara në aksionet e tij (shpërblime zëvendësimi) me shpërblimet që kanë pasur punonjësit e njësisë së blerë. Shkëmbimet e opsioneve në aksione apo shpërblimeve të tjera me pagesa të bazuara në aksione në lidhje me një kombinim biznesi trajtohen si ndryshime të shpërblimeve me pagesa të bazuara në aksione në përputhje me SNRF 2 *Pagesat e bazuara në aksione*. Në qoftë se blerësi është i detyruar të zëvendësojë shpërblimet e njësisë së blerë, ose të gjitha ose një pjesë të masës të bazuar në tregun e shpërblimeve zëvendësuese të njësisë së blerë do të përfshihen në matjen e shumës së transferuar në kombinimin e biznesit. Paragrafët B57–B62 japin udhëzime se si të caktohet masa e bazuar në treg. Blerësi është i detyruar të zëvendësojë shpërblimet e njësisë së blerë nëse kjo njësi ose punonjësit e saj kanë aftësinë për të zbatuar zëvendësimin. Për shembull, për qëllime të zbatimit të kësaj kërkesë, blerësi është i detyruar të zëvendësojë shpërblimet e njësisë së blerë në qoftë se zëvendësimi është kërkuar nga:

- a) kushtet e marrëveshjes së blerjes;
- b) kushtet e shpërblimeve të njësisë së blerë; ose
- c) ligjet e zbatueshëm ose rregulloret.

Megjithatë, në disa situata, në të cilat shpërblimet e njësisë së blerë mund do të skadonin si pasojë e një kombinimi biznesi dhe, në qoftë se blerësi i zëvendëson këto shpërblime kur edhe pse ai nuk është i obliguar ta bëjë këtë, e gjithë masa e bazuar në tregun e këtyre shpërblimeve zëvendësuese duhet të njihet si kosto shpërblimi në pasqyrat financiare pas kombinimit në përputhje me SNRF 2. Kjo do të thotë se masa e bazuar në treg e këtyre shpërblimeve nuk do të përfshihet në matjen e shumës së transferuar në kombinimin e biznesit. Blerësi është i detyruar të zëvendësojë shpërblimet e

⁺ Në paragrafët B56–B62 termi “shpërblimet e bazuara në aksione” i referohet transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione të kushtëzuara ose jo.

njesisë së blerë nëse kjo njësi ose punonjësit e saj kanë aftësinë për të zbatuar zëvendësimin. Për shembull, për qëllime të zbatimit të këtij udhëzuesi, blerësi është i detyruar të zëvendësojë shpërblimet e njesisë së blerë nëse zëvendësimi është kërkuar nga:

- a) kushtet e marrëveshjes së blerjes;
- b) kushtet e shpërblimeve të njesisë së blerë; ose
- c) ligjet e zbatueshme ose rregulloret.

Transaksione pagese me aksione (i shlyer në kapital neto) të njesisë së blerë

B62A Njësia e blerë mund të ketë transaksione pagese me aksione të pashlyera që blerësi nuk i shkëmben për transaksionet e tij të pagesës bazuar në aksione. Nëse janë të kushtëzuara, këto transaksione pagese me aksione të njesisë së blerë janë pjesë e interesave jokontrolluese në njësinë e blerë dhe maten me masën e tyre të bazuar në treg. Nëse janë të pakushtëzuara, ato maten me masën e tyre të tregut sikur data e blerjes të ishte në datën e dhënies në përputhje me paragrafët 19 dhe 30.

B62B Masa e bazuar në treg e transaksioneve të pakushtëzuara të pagesave të bazuara në aksione shpërndahet në interesin jokontrollues mbi bazën e raportit të pjesës së periudhës së kushtëzimit të përfunduar kundrejt periudhës më të gjatë të asaj të kushtëzimit total apo periudhës fillestare të kushtëzimit të transaksioneve të pagesës me aksione. Teprica kalohet në shërbimin pas kombinimit.

Shtojca për amendime në SNRF 3

Amendime në SNRF-të e tjera

SNRF 7 *Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese*

Paragrafi 44B është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar) dhe është shtuar paragrafi 44K.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

44B Hiqet paragrafi 3 (c) i SNRF 3 (rishikuar në 2008). Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2009 e në vijim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNRF 3 (rishikuar 2008) për një periudhë më të hershme, ndryshimi do të zbatohet edhe për këtë periudhë të hershme. Megjithatë, ndryshimi nuk ka të bëjë me shumën e kushtëzuar që ka rrjedhur nga një kombinim biznesi, për të cilin data e blerjes i paraprin zbatimit të SNRF 3 (rishikuar në vitin 2008). Në vend të kësaj, një njësi ekonomike do ta trajtojë një shumë të tillë në përputhje me paragrafët 65A–65E të SNRF 3 (i ndryshuar në vitin 2010).

44K Paragrafi 44B u ndryshua nga *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2010. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2010 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date.

SNK 32 *Instrumentet financiare: Paraqitja*

Paragrafi 97B është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar) dhe është shtuar paragrafi 97G.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

97B Hiqet paragrafi 4 (c) i SNRF 3 (rishikuar në 2008). Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2009 e në vijim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNRF 3 (rishikuar 2008) për një periudhë më të hershme, ndryshimi do të zbatohet edhe për këtë periudhë të hershme. Megjithatë, ndryshimi nuk ka të bëjë me shumën e kushtëzuar që ka rrjedhur nga një kombinim biznesi, për të cilin data e blerjes i paraprin zbatimit të SNRF 3 (rishikuar në vitin 2008). Në vend të kësaj, një njësi ekonomike do ta trajtojë një shumë të tillë në përputhje me paragrafët 65A–65E të SNRF 3 (i ndryshuar në vitin 2010).

97G Paragrafi 97B u ndryshua nga *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2010. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2010 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date.

SNK 39 Instrumentet financiare: Njohja dhe matja

Paragrafi 103D është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar) dhe është shtuar paragrafi 103N.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

103D Hiqet paragrafi 2(f) i SNRF 3 (rishikuar në 2008). Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2009 e në vijim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNRF 3 (rishikuar 2008) për një periudhë më të hershme, ndryshimi do të zbatohet edhe për këtë periudhë të hershme. Megjithatë, ndryshimi nuk ka të bëjë me shumën e kushtëzuar që ka rrjedhur nga një kombinim biznesi, për të cilin data e blerjes i paraprin zbatimit të SNRF 3 (rishikuar në vitin 2008). Në vend të kësaj, një njësi ekonomike do ta trajtojë një shumë të tillë në përputhje me paragrafët 65A–65E të SNRF 3 (i ndryshuar në vitin 2010).

103N Paragrafi 103D u ndryshua nga *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2010. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2010 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date.

Amendime në SNRF 7 Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese

Paragrafi 32A është shtuar. Paragrafët 34 dhe 36–38 janë ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe tekstit të fshirë i është vënë viza). Paragrafi 44L është shtuar.

Natyra dhe shkalla e rreziqeve që rrjedhin nga instrumentet financiare

32A Sigurimi i informacioneve shpjeguese cilësore në kontekstin e dhënies së informacioneve shpjeguese sasiore mundëson përdoruesit që duke u nisur nga dhënia e informacioneve shpjeguese përkatëse të formojnë një pamje të përgjithshme të natyrës dhe shkallës së rreziqeve që rrjedhin nga instrumentet financiare. Bashkëveprimi në mes dhënies së informacioneve shpjeguese sasiore dhe cilësore kontribuon për dhënien e informacionit në një mënyrë që u mundëson përdoruesve të vlerësojnë më mirë ekspozimin ndaj rreziqeve të një njësie ekonomike.

Dhënia e informacioneve shpjeguese sasiore

34 Për çdo lloj rreziku që vjen nga instrumentet financiare, një njësi ekonomike duhet të paraqesë:

a) të dhëna përmbledhëse sasiore lidhur me ekspozimin e saj ndaj rrezikut në fund të periudhës raportuese. Ky informacion shpjegues duhet të bazohet në informacionin e brendshëm për personelin kyç menaxhues të njësisë ekonomike (siç përcaktohet në SNK 24 *Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura*), për shembull bordin e drejtorëve të njësisë ekonomike ose shefin ekzekutiv.

b) dhënien e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga paragrafët 36–42, për aq sa nuk është dhënë në përputhje me (a), përveç nëse rreziku është material (shih paragrafët 29–31 të SNK 1 në lidhje me materialitetin).

c) përqendrimet e rrezikut nëse nuk dalin qartë nga dhënia e informacioneve shpjeguese e bërë në përputhje me (a) dhe (b).

Rreziku i kredisë

36. Një njësi ekonomike duhet të paraqesë për klasën e instrumentit financiar:

a) shumën që përfaqëson më së miri ekspozimin e saj maksimal ndaj rrezikut të kredisë në fund të periudhës raportuese, pa marrë parasysh ndonjë kolateral të mbajtur apo aktiv që mbahet si garanci kredie (p.sh. marrëveshjet për neto që nuk kualifikohen për kompensim në përputhje me SNK 32); kjo dhënie e informacioneve shpjeguese nuk kërkohet për instrumentet financiare, vlera kontabël neto e të cilave përfaqëson më së miri ekspozimin maksimal ndaj rrezikut të kredisë;

b) ~~në lidhje me shumën që jepet informacion shpjegues në (a)~~, një përshkrim i kolateralit të mbajtur për siguri dhe i aktiveve të tjera të mbajtura si garanci të kredisë dhe efekti i tyre financiar

(p.sh. një përcaktim i masës me të cilën kolaterali dhe aktiv tjetër i mbajtur si garanci i kredisë parandalojnë rrezikun e kredisë) në lidhje me shumën që përfaqëson më së miri ekspozimin maksimal ndaj rrezikut të kredisë (nëse është dhënë informacion shpjegues në përputhje me (a) ose është përfaqësuar nga vlera kontabël neto e një instrumenti financiar).;

c) informacionin në lidhje me cilësinë e kredisë të aktiveve financiare që as nuk ju ka kaluar afati, as janë të zhvlerësuar; dhe

d) ~~[fshirë] vlerën kontabël neto të aktiveve financiare që përndryshe do t'ju kishte kaluar afati apo do ishin të zhvlerësuar, kushtet e të cilave kanë qenë të rinegociuara.~~

Aktivet financiare që ose ju ka kaluar afati ose janë të zhvlerësuar

37 Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për klasën e aktivit financiar:

a) një analizë të moshës së aktiveve financiare që ju ka kaluar afati në fund të periudhës raportuese, por nuk janë të zhvlerësuar; dhe

b) një analizë të aktiveve financiare që janë të përcaktuara individualisht të zhvlerësuar në fund të periudhës raportuese, duke përfshirë edhe faktorët që njësi ekonomike i ka marrë parasysh në përcaktimin se ato janë të zhvlerësuar; dhe

c) ~~[fshirë] për shumat që jepet informacion shpjegues në (a) dhe (b), një përshkrim i kolateralit të mbajtur nga njësi ekonomike dhe të ndonjë aktiv tjetër të mbajtur si garanci kredie dhe, përveçse kur është praktikisht e mundur, një vlerësim të vlerës së drejtë të tyre.~~

Kolaterali dhe aktivet e tjera të marra për garanci kredie

38 Kur një njësi ekonomike merr aktive financiare ose jofinanciare gjatë periudhës, duke fituar posedimin e kolateralit që mban si garanci ose duke kërkuar aktive të tjera për garanci (p.sh. garancitë), dhe aktive të tilla plotësojnë kriteret e njohjes në SNRF-të e tjera, një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për këto aktive të mbajtura në datën e raportimit:

a) natyrën dhe vlerën kontabël neto të aktiveve të marra; dhe

b) kur aktivet nuk janë lehtësisht të konvertueshme në mjete monetare, politikat e saj për shitjen e aktiveve të tilla ose për përdorimin e tyre në veprimtaritë e saj.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

44L Nga *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2010 është shtuar paragrafi 32A dhe janë ndryshuar paragrafët 34 dhe 36–38. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2010 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

Amendime në

SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare

Para paragrafit 106 është vendosur një titull. Paragrafi 106 është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe tekstit të fshirë i është vënë viza). Pas paragrafit 106 është vendosur një titull dhe është shtuar paragrafi 106A. Paragrafi 107 është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar). Paragrafi 139F është shtuar.

Struktura dhe përmbajtja

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto

Informacioni që paraqitet në pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto

106 Një njësi ekonomike duhet të paraqesë një pasqyrë të ndryshimeve në kapitalin neto siç kërkohet nga paragrafi 10. Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto përfshin informacionin e mëposhtëm duke treguar në pasqyrë:

a) të ardhurat totale të përgjithshme për periudhën, duke treguar veçmas shumat totale që u takon pronarëve të mëmës dhe interesave të pakicës;

b) për çdo përbërës të kapitalit neto, efektet e zbatimit retrospektiv ose riparaqitjen retrospektive të njohur në përputhje me SNK 8, dhe

c) [fshirë]

d) për çdo përbërës të kapitalit neto, një rakordim në mes vlerës kontabël neto në fillim dhe në fund të periudhës, duke dhënë veçmas informacion shpjegues për ndryshimet që rezultojnë nga:

i) fitimi ose humbja;

ii) ~~çdo zë~~ të ardhurat e tjera të përgjithshme; dhe

iii) transaksionet me pronarët në cilësinë e tyre si pronarë, duke treguar veçmas kontributet nga dhe shpërndarjet për pronarët dhe ndryshimet në interesat e pronësisë në filiale, të cilat nuk çojnë në një humbje të kontrollit.

Informacion që paraqitet në pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto ose në shënimet shpjeguese

106A Për çdo përbërës të kapitalit neto një njësi ekonomike duhet të paraqesë, ose në pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto ose në shënime, një analizë të të ardhurave të tjera të përgjithshme sipas zërit (shih paragrafin 106 (d) (ii)).

107 Një njësi ekonomike duhet të paraqesë, ose në pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto ose në shënimet shpjeguese, shumat e dividendëve të njohura si shpërndarje për pronarët gjatë periudhës, dhe shumat përkatëse të dividendëve për aksion.

Periodha kalimtare dhe data e hyrjes në fuqi

139F Paragrafët 106 dhe 107 janë ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 106A nga *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2010. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2011 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date.

Kërkesat kalimtare për ndryshimet që rrjedhin si rezultat i SNK 27 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale

Amendime në SNRF-të

SNK 21 Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit të monedhave të huaja

Paragrafi 60B është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar) dhe është shtuar paragrafi 60D.

Data e hyrjes në fuqi dhe periodha kalimtare

60B SNK 27 (i ndryshuar në vitin 2008) shtoi paragrafët 48A-48D dhe paragrafi 49 u ndryshua. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2009 e në vijim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 27 (i ndryshuar 2008) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë të hershme.

60D Paragrafi 60B u ndryshua nga *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2010. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2010 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date.

SNK 28 Investime në pjesëmarrje

Paragrafi 41B është shtuar (teksti i ri është nënvizuar dhe tekstit të fshirë i është vënë viza) dhe është shtuar paragrafi 41E.

Data e hyrjes në fuqi dhe periodha kalimtare

41B Në SNK 27 (i ndryshuar në vitin 2008) janë ndryshuar paragrafët 18, 19 dhe 35 dhe është shtuar paragrafi 19A. Një njësi ekonomike do të zbatojë ndryshimin në paragrafin 35 në mënyrë retrospektive dhe këtë ndryshim në paragrafët 18 dhe 19 dhe në paragrafin 19A në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2009 e në vijim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 27 (i ndryshuar 2008) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë të hershme.

41E Paragrafi 41B u ndryshua nga *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2010. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2010 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimin para datës 1 korrik 2010, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

SNK 31 Interesat në Sipërmarrjet e Përbashkëta

Paragrafi 58A është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe tekstit të fshirë i është vënë viza) dhe është shtuar paragrafi 58D.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

58A Në SNK 27 (i ndryshuar në vitin 2008) janë ndryshuar paragrafët 45 dhe 46 dhe janë shtuar paragrafët 45A dhe 45B. Një njësi ekonomike do të zbatojë ndryshimin në paragrafin 46 në mënyrë retrospektive dhe këto ndryshimet në paragrafin 45 dhe paragrafët 45A dhe 45B në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2009 e në vijim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 27 (i ndryshuar 2008) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë të hershme.

58D Paragrafi 58A u ndryshua nga *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2010. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2010 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimin para datës 1 korrik 2010 ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

Amendime në

SNK 34 Raportimi financiar i ndërmjetëm

Një titull dhe paragrafi 15 janë ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe tekstit të fshirë i është vënë viza). Paragrafët 15A-15C janë shtuar. Paragrafët 16-18 janë fshirë. Një titull dhe paragrafi 16A janë shtuar. Paragrafi 49 është shtuar. Paragrafët 15B dhe 16A ishin më parë paragrafët 17 dhe 16, përkatësisht, si dhe janë dhënë deri në masën për të treguar vetëm ndryshimet nga teksti paraekzistues.

Përmbajtja e një raporti financiar të ndërmjetëm

Shënimet shpjeguese të zgjedhura Ngjarjet dhe transaksionet e rëndësishme

15 Një përdorues i raportit financiar të ndërmjetëm të një njësie ekonomike do të ketë gjithashtu të drejtën e qasjes në raportin financiar më të fundit vjetor të kësaj njësie. Prandaj është e nevojshme, që shënimet shpjeguese në një raport financiar të ndërmjetëm të sigurojnë informatat më të reja relativisht të parëndësishme për informacionin që tashmë është raportuar në shënimet e raportit vjetor më të fundit. Në një datë të ndërmjetme, Një njësi ekonomike duhet të përfshijë në raportin financiar të ndërmjetëm të saj një shpjegim të ngjarjeve dhe transaksioneve që janë të rëndësishme për të kuptuar ndryshimet në pozicionin financiar dhe performancën e njësisë ekonomike që nga fundi i periudhës vjetore raportuese më të fundit është më e dobishme. Informacioni shpjegues në lidhje me këto ngjarje dhe transaksione duhet përditësuar që të japë informacionin përkatës të paraqitur në raportin financiar vjetor më të fundit.

15A Një përdorues i raportit financiar të ndërmjetëm të një njësie ekonomike do të ketë të drejtën e aksesit në raportin financiar vjetor më të fundit të kësaj njësie. Prandaj, është e panevojshme që shënimet shpjeguese në një raport financiar të ndërmjetëm të sigurojnë informatat më të reja relativisht të parëndësishme për informacionin që është raportuar në shënimet shpjeguese të raportit financiar vjetor më të fundit.

15B ~~Më poshtë janë dhënë shembuj të llojeve të informacioneve shpjeguese që kërkohen sipas paragrafit 16. SNRF të veçanta japin udhëzime në lidhje me dhënien e informacioneve shpjeguese për shumë nga këta zëra: Më poshtë është një listë e ngjarjeve dhe transaksioneve, për të cilat dhënia e informacioneve shpjeguese do të jetë e nevojshme nëse ato janë të rëndësishme: lista nuk është shteruese.~~

a) ulja e vlerës së inventarëve në vlerën neto të realizueshme dhe anulimi i një zhvlerësimi të tillë;

b) njohja e një humbje nga zhvlerësimi i aktiveve financiare, aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve të tjera, dhe anulimi i një humbjeje të tillë nga zhvlerësimi;

c) anulimi i ndonjë provizionit për kostot e ristrukturimit;

d) blerja dhe shitja e zërave: ndërtesa, tokë, makineri dhe pajisje;

e) angazhimet për blerje: ndërtesa, tokë, makineri dhe pajisje;

f) zgjidhja e mosmarrëveshjeve gjyqësore;

g) korrigjimet e gabimeve të periudhave të mëparshme;

~~h) [fshirë]~~ ndryshimet në biznes ose në rrethanat ekonomike që ndikojnë në vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të njësisë ekonomike, nëse këto aktive ose detyrime janë njohur me vlerën e drejtë apo koston e amortizuar;

i) çdo hua të shtyrë ose shkelje të një marrëveshje kredie që nuk është rregulluar në ose para përfundimit të periudhës raportuese; dhe

j) transaksionet me palët e lidhura;

k) transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë të përdorur në matjen e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare;

l) ndryshimet në klasifikimin e aktiveve financiare si rezultat i një ndryshimi në qëllimin ose përdorimin e këtyre aktiveve; dhe

m) ndryshimet në detyrimet ose aktivet e kushtëzuara.

15C SNRF-të individuale japin udhëzime në lidhje me kërkesat për dhënien e informacioneve shpjeguese për shumë nga zërat e listuar në paragrafin 15B. Kur një ngjarje ose transaksion është i rëndësishëm për të kuptuar ndryshimet në gjendjen financiare të njësisë ekonomike ose performancën e saj që nga periudha raportuese vjetore e fundit, raporti financiar i ndërmjetëm i saj duhet të japë një shpjegim dhe një përditësim të informacionit përkatës të përfshirë në pasqyrat financiare të periudhës raportuese vjetore të fundit.

16–18 [Fshirë]

Dhënia e informacioneve shpjeguese të tjera

16A Përveç dhënies së informacioneve shpjeguese për ngjarjet dhe transaksionet e rëndësishme në përputhje me paragrafët 15-15C, një njësi ekonomike do të përfshijë informacionin e mëposhtëm, si një minimum, në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të ndërmjetme të saj, ~~qoftë materiale dhe~~ nëse nuk është dhënë informacion shpjegues diku tjetër në raportin financiar të ndërmjetëm. Normalisht informacioni duhet të raportohet në bazë të vitit financiar që nga fillimi i vitit deri në momentin aktual. ~~Megjithatë, njësi ekonomike duhet të japë gjithashtu informacion shpjegues për ngjarjet ose transaksionet që janë materiale, të nevojshme për kuptimin e periudhës aktuale të ndërmjetme:~~

a) një pohim që janë ndjekur të njëjtat politika kontabël dhe metoda të llogaritjes në pasqyrat financiare të ndërmjetme në krahasim me pasqyrat financiare vjetore më të fundit, ose, nëse këto politika apo metoda kanë ndryshuar, një përshkrim i natyrës dhe efektit të ndryshimit;

b) komentet shpjeguese në lidhje me sezonalitetin ose periodicitetin të veprimtarive të ndërmjetme;

c) natyrën dhe shumën e zërave që ndikojnë në aktivet, pasivet, kapitalin neto, të ardhurat neto ose flukset e mjeteve monetare, të cilat janë të pazakonta për shkak të natyrës, madhësisë apo ndodhjes së tyre;

d) natyrën dhe shumën e ndryshimeve në vlerësimet e shumave të raportuara në periudhat e mëparshme të ndërmjetme të vitit aktual financiar ose ndryshimet në vlerësimet e shumave të raportuara në vitet financiare të mëparshme, ~~në qoftë se këto ndryshime kanë një efekt material në periudhën aktuale të ndërmjetme;~~

e) ~~nxjerrjet~~, emetimet, riblerjet dhe ripagesat e borxhit dhe të letrave me vlerë të kapitalit;

f) dividendët e paguar (në total ose për aksion) veç e veç për aksionet e zakonshme dhe aksionet e tjera;

g) informacionin e mëposhtëm të segmentit (dhënia e informacionit shpjegues të segmentit kërkohet në një raport financiar të ndërmjetëm të një njësie ekonomike vetëm nëse SNRF 8 *Segmentet e shfrytëzimit* kërkon që njësi ekonomike të japë informacion shpjegues për segmentin në pasqyrat financiare vjetore të saj):

i) të ardhurat nga klientët e jashtëm, nëse përfshihen në masën e fitimit ose humbjes së segmentit, rishikuar nga shefi operativ i marrjes së vendimeve ose kur rregullisht parashikohet ndryshe nga shefi operativ i marrjes së vendimeve;

ii) të ardhurat midis segmenteve, nëse përfshihen në masën e fitimit ose humbjes të segmentit rishikuar nga shefi operativ i marrjes së vendimeve ose kur rregullisht parashikohet ndryshe nga shefi operativ i marrjes së vendimeve;

iii) një madhësi të fitimit ose humbjes neto të segmentit;

iv) aktivet gjithsej për të cilat ka pasur një ndryshim material nga shuma e paraqitur në pasqyrat financiare vjetore të fundit;

v) një përshkrim të diferencave nga pasqyrat financiare vjetore të fundit në bazë të segmentimit ose në bazë të matjes së fitimit ose humbjes neto të segmentit.;

vi) një rakordim të totalit të madhësive të fitimit ose humbjes neto të segmenteve raportuese me fitimin ose humbjen neto të njësisë ekonomike para zbritjes së shpenzimeve tatimore (të ardhurat tatimore) dhe veprimtaritë jo të vijueshme. Megjithatë, në qoftë se një njësi ekonomike shpërndan në segmentet raportuese elemente të tilla, si: shpenzimet tatimore (të ardhurat tatimore), njësia ekonomike mund të rakordojë totalin e madhësive të fitimit ose humbjes neto të segmenteve me fitimin ose humbjen neto pas shpërndarjes së këtyre zërave. Zërat materialë në rakordim duhet të identifikohen veças dhe të përshkruhen në këtë rakordim.;

h) ngjarjet materiale të mëvonshme deri në fund të pas periudhës së ndërmjetme të cilat nuk janë pasqyruar në pasqyrat financiare për periudhën e ndërmjetme.;

i) efektin e ndryshimeve në përbërjen e njësisë ekonomike gjatë periudhës së ndërmjetme, duke përfshirë kombinimet e biznesit, marrjen ose humbjen e kontrollit të filialeve dhe investimeve afatgjata, ristrukturimet dhe operacionet jo të vijueshme. Në rastin e kombinimeve të biznesit, njësia ekonomike do të japë informacionin shpjegues të kërkuar nga SNRF 3 Kombinimet e Biznesit.;

j) ndryshimet në detyrimet ose aktivet e kushtëzuara qysh nga fundi i periudhës raportuese vjetore të fundit.

Data e hyrjes në fuqi

49 Nga *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2010, paragrafi 15 u ndryshua, janë shtuar paragrafët 15A-15C dhe 16A, ndërsa paragrafët 16-18 janë fshirë. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2011 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

Amendime në

KIRFN 13 Programet e besnikërisë ndaj konsumatorit

Paragrafi 10A është shtuar.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

10A Paragrafi AG2 u ndryshua nga *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2010. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2010 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimin para datës 1 korrik 2010, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

Shtojcë

Udhëzim për zbatim

Paragrafi AG2 ka ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe tekstit të fshirë i është vënë viza).

AG2 Një njësi ekonomike mund të vlerësojë vlerën e drejtë të krediteve të çmimit, duke iu referuar vlerës së drejtë të çmimeve për të cilat ato mund të blihen. Vlera e drejtë e këtyre çmimeve do të zvogëlohet për të marrë krediteve të çmimit merr parasysh, sipas rastit:

a) shumën e zbritjeve apo të stimujve, vlerat e drejta të çmimeve që ndryshe do t'u ofroheshin klientëve, të cilët nuk kanë fituar kredite çmimi nga shitja fillestare; dhe

b) përqindjen e krediteve të çmimit që nuk pritët të riblihen nga konsumatorët.

Nëse konsumatorët mund të zgjedhin nga një gamë çmimesh të ndryshme, vlera e drejtë e krediteve të çmimit do të pasqyrojë vlerat e drejta të serisë së çmimeve të disponueshme, ponderuar në përpjesëtim me frekuencën me të cilën çdo çmim pritët të jetë zgjedhur.

URDHËR
Nr.33, datë 28.2.2011

**PËR DELEGIMIN E AUTORITETIT, PËR MIRATIMIN E PAGESAVE TË SHITESËS PËR
ORË PUNE MBI KOHËN NORMALE TË PUNËS, PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË
SHETIT**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 27-33 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, të ndryshuar, të pikës 2/c të nenit 7 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.591, datë 23.7.2010 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit të autoritetit për miratimin e pagesave të shtesës për orë pune mbi kohën normale të punës, për punonjësit e Policisë së Shtetit.
 2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit me zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Lulzim Basha

KËRKESË
Nr.649/3, datë 3.3.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën, për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza lindore-Shkodër” (truall, shtesa pas ndryshimit të projektit).

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp, kërkojnë të vënë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Pronarët për të cilët është bërë shënimi në “Proces regjistrimi nga ZRPP-ja” do të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar ky proces dhe të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë DPRR-së.

Pronarët, për të cilët në kolonën “Shënime” në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private, për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 95 299 600 (nëntëdhjetë e pesë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
REJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR SIPËRFAQE TRUALLI NGA NDËRTIMI I UNAZËS LINDORE,
SHKODËR

Nr.	Pronari	ZK	Nr. pas.	Sip. m ²	Çmimi lekë m ²	Vlera në lekë	Shënime
1.	Nadire, Satbere, Qeuthere Zekja	8597	10/96	269	8500	2286500	Konfirmuar nga ZRPP-ja
2.	Trashëg. Zekja	8597	10/116	182	8500	1547000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
3.	Trashëg. Zekja	8597	10/113	766.4	8500	6514400	Proces regjistrimi
4.	Trashëg. Paqrami	8597	7/60	1197	8500	10174500	Proces regjistrimi
5.	Ndue Binak Marku, Angjelin Voci	8597	3/128	11.3	8500	96050	Konfirmuar nga ZRPP-ja
6.	Klaudio Bledi, Shqyri Hasaj	8597	7/82	873	8500	7420500	Konfirmuar nga ZRPP-ja
7.	Ismet Osmani	8597	5/15	47.1	8500	400350	Proc.regj.TR. Dibra
8.	Trashëg. Dibra	8597	5/89	4.6	8500	39100	Konfirmuar nga ZRPP-ja
9.	Trashëg. Dibra	8597	5/90	256.5	8500	2180250	Konfirmuar nga ZRPP-ja
10.	Tom Kol Radoja	8597	3/11	20.6	8500	175100	Konfirmuar nga ZRPP-ja
11.	Sokol Kol Tahiri	8597	3/8+1-4	49.6	8500	421600	Konfirmuar nga ZRPP-ja
12.	Ndue Molla	8597	3/30	20	8500	170000	Proces regjistrimi
13.	Fejzi Mhemeti	8597	3/33	3.1	8500	26350	Proces regjistrimi
14.	Trashëg. Bushati	8594	9/188	86.1	8500	731850	Konfirmuar nga ZRPP-ja
15.	Trashigim Sykja	8594	9/194	313.8	8500	2667300	Konfirmuar nga ZRPP-ja
16.	Dod Mardoda	8594	9/159	300	8500	2550000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
17.	Frano Dede Shqau	8594	9/116	98.4	8500	836400	Konfirmuar nga ZRPP-ja
18.	Tashigim Lohja	8594	11/78	990.5	8500	8419250	Proces regjistrimi
19.	Sokol Ndue Braci	8594	12/400	62.5	8500	531250	Konfirmuar nga ZRPP-ja
20.	I pa identifikuar	8594	12/802	26	8500	221000	Konflik pronësie
21.	I pa identifikuar	8594	12/398	90	8500	765000	Proces regjistrimi
22.	Trashëg. Bushati	8593	10/187	343	8500	2915500	Konfirmuar nga ZRPP-ja
23.	Paulin Radovani	8593	10/75	182.4	8500	1550400	Proces regjistrimi
24.	Trashigim. Bushati	8593	10/186	124.3	8500	1056550	Konfirmuar nga ZRPP-ja
25.	Pjerin Lleshi	8593	10/171	165	8500	1402500	Konfirmuar nga ZRPP-ja
26.	Tonin Beka	8593	10/163	173	8500	1470500	Konfirmuar nga ZRPP-ja
27.	Tonin Beka	8593	10/172	60.4	8500	513400	Konfirmuar nga ZRPP-ja
28.	Paulin Radovani	8593	8/300	20	8500	170000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
29.	Lin Preka	8593	11/309	345.7	15000	5185500	Proces regjistrimi
30.	Marin Marnishta	8593	13/295	22	15000	330000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
31.	Shan Deda	8593	12/65	970	15000	14550000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
32.	Teofik Curcija	8592	9/706	45	15000	675000	Proces regjistrim
33.	Trashigim Çurcija	8592	10/155	65.8	15000	987000	Proces regjistrimi
34.	Benik Fadil Alia	8592	12/249	160.3	15000	2404500	Konfirmuar nga ZRPP-ja
35.	Fadil Halluni	8592	12/153	52	8500	442000	Proces regjistrimi
36.	Selamet Kryeziu	8592	8/48	180.2	15000	2703000	Proces regjistrimi
37.	Perlat Rexhep Rexhvelaj	8592	8/318	41.5	15000	622500	Konfirmuar nga ZRPP-ja
38.	Trashëg. Gerqari	8592	6/609	20.5	15000	307500	Proces regjistrimi
39.	Seit Gerqari	8592	6/334	35.6	15000	534000	Proces regjistrimi
40.	Musa Gerqari	8592	6/382	238.1	15000	3571500	Proces regjistrimi
41.	Musa Gerqari	8592	6/381	28	15000	420000	Proces regjistrimi
42.	Ferit Halluni	8592	12/158	42	15000	630000	Proces regjistrimi
43.	Xhavit Halluni	8592	12/171	114.5	15000	1717500	Proces regjistrimi
44.	Murat Halluni	8592	12/172	19.8	15000	297000	Proces regjistrimi
45.	Nazmi Haliti	8592	12/228	3.4	15000	15000	Proces regjistrimi
46.	Savedin Haliti	8592	12/229	10	15000	150000	Proces regjistrimi
47.	Said Gjonlija	8592	12/233	62.8	15000	942000	Proces regjistrimi
48.	Safet Gerqari	8592	12/272	29	15000	435000	Proces regjistrimi
49.	Vaid Halluni	8592	12/259	38	15000	570000	Proces regjistrimi
50.	Faruk Hallumi	8592	12/260	34.8	15000	522000	Proces regjistrimi
	Totali			9294.6		95299600	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 23.3.2011
Doli nga shtypi më 25.3.2011

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë